

# PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2022

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008, “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

#### Neni 1

Nën nenin 63, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës, për të cilin përfundon me sukses procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ”.

#### Neni 2

Pas nenit 63, shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

#### Neni 63/1

#### “Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës”

1. Subjekti zgjedhor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve, për listën e kandidatëve, për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, potencialisht e mundshem paraqet kërkesë dhe formualin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në

lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.

2. Kandidati i pavarur për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për të, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës së pastërtisë së figurës.
3. Në çdo rast Autoriteti me marrjen njoftim nga KQZ-ja, lidhur me regjistrimin e listës së kandidatëve 50 ditë përpara ditës së zgjedhjeve që konkurojnë për zgjedhjet e radhës, kryen procesin e verifikimit dhe përgjigjet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 dhe 30, të ligjit nr. 44/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, duke informuar subjektin që ka bërë kërkesën dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
4. Verifikimi i figurës së pastërtisë të kandidateve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetë deklarojë, dhe nëse vet deklarimi është i rremë në raport me rezultatin e verifikimit sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit 45/2015, atëherë çështja dërgohet pranë KQZ-së, e cila e përcjell më tej në organet kompetente të hetimit dhe gjyqimit, veprime këto që sjellin penalitetet e duhura.

### **Neni 3 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**LINDITA NIKOLLA**